

REGJISTRI KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE - PRILL 2025

NR. RENDOR	DATA E KËRKESËS	OBJEKTI I KËRKESËS	DATA E PËRGJIGJES	PËRGJIGJE	MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË KËRKESËS	TARIFA
1	03.04.2025	Kërkesë	05.04.2025	Në përgjigje të shkresës Suaj..... ju bëjmë me dije se; Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT),e cila aktualisht funksionon si Sekretariat Teknik i KKTU-së, është krijuar me VKM-në Nr.725,datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizmit dhe funksionimit të AZHT" i ndryshuar. Në mbështetje të VKM-së sipërcituar, kjo Agjenci ka kompetencë pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit tekniko-ligjor që shqyrtohet në mbledhjet e KKTU, me qëllim miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga KKTU. ... Në vijim,Ju informojmë se AZHT,disponon të gjitha vendimet që janë miratuar nga KKT, prej tetorit të vitit 2015 e në vijim,ndërkohë,lidhur me vendimet e miratuara nga KKT deri në tetor të vitit 2015, procedurën e kryer, si dhe materialet përkatëse të këtyre vendimeve,ju orientojmë t'i drejtoheni Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT),e cila ka ushtruar funksionet e Sekretariatit Teknik të KKT-së, deri në momentin e krijimit të AZHT.	E plotë	Nuk ka
2	07.04.2025	Kërkesë për informacion	14.04.2025	Referuar kërkesës Suaj për informacion drejtuar nëpërmjet adresës elektronike, bazuar në Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ju informojmë si më poshtë: Në sistemin elektronik e-leje është depozituar aplikimi..... Aktualisht, nuk ka ende një vendimarrje nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit (KKTU) për këtë aplikim. Sa i takon procedurës dhe dokumentave të nevojshme për pajisje me leje ndërtimi, sqarojmë se ato përcaktohen nga VKM Nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, e ndryshuar, konkretisht neni 15, i cili përcakton dokumentacionin e nevojshëm. Theksojmë se në rast se zhvilluesi nuk plotëson kriteret ligjore të parashikuara në VKM-në e sipërcituar si dhe aktet e tjera ligjore në fuqi, aplikimi refuzohet.	E plotë	Nuk ka

3	09.04.2025	Kërkesë për informacion	22.04.2025	Në përgjigje të kërkesës Suaj, drejtuar nëpërmjet adresës elektronike, ju sqarojmë si më vijon: AZHT, e cila aktualisht funksionon si Sekretariat Teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, në mbështetje të Vendimit Nr. 725, datë 02.09.2015 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, ka kompetencë pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit që shqyrtohet dhe miratohet në mbledhjet e KKTU-së. Pranë AZHT, është depozituar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, aplikimi... Në vijim, në përputhje me Ligjin Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, KKT... ka miratuar Vendimin .., për të cilën pas plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor është lëshuar dhe dokumenti i Lejes së Ndërtimit.... Në vijim sqarojmë se, referuar Nenit 3 “E drejta e informimit”, pika 4, të Ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” (Ligj të cilit ju i referoheni edhe në shkresën tuaj) citohet se: “Informacioni publik, që i është dhënë një personi, nuk mund t’i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjekteve, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji”, Gjithashtu referuar Nenit 17 “Kufizime”, pika 1, shkronja “c”, po të Ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, citohet se: <i>“1. E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm:</i> ... <i>c) të drejtën e autorit;</i> <i>Kufizimi i së drejtës së informimit, për shkak të interesave të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të kësaj pike, nuk zbatohet kur titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës ose kur në momentin e dhënies së informacionit ai është konsideruar autoritet publik në bazë të parashikimeve të këtij ligji. Pavarësisht nga sa parashikohet në këtë pikë, informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij.</i> Bashkëlidhur gjeni dokumentat....	E plotë	Nuk ka
---	------------	-------------------------	------------	---	---------	--------

4	11.04.2025	Kërkesë	18.04.2025	Në përgjigje të shkresës suaj...,Ju informojmë se: AZHT, e cila aktualisht funksionon e Sekretariat Teknik të KKTU-së,është krijuar me Vendimin Nr. 725, datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar.Në mbështetje të VKM-së sipërcituar, kjo Agjenci ka kompetencë pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionin që shqyrtohet në mbledhjet e KKTU, me qëllim miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga KKTU. Pranë AZHT është depozituar nëpërmjet sistemit "e-leje",aplikimiTheksojmë se ky vendim është ende në proces zbardhjeje,proces i cili do të përfundohej vetëm pas plotësimit të kushteve sa i takon dokumentacionit tekniko-ligjor në lidhje me projektin e sipërcituar. Në vijim ju bëjmë me dije se AZHT,bazuar në Ligjin Nr.107/2014,datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".i ndryshuar,si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij,do të vijojë me procedurat për lëshimin e dokumnetiti të lejes së ndërtimit vetëm pas plotësimit të të gjithë dokumentacionit tekniko-ligjor të nevojshëm. Për sa më sipër,theksojmë se çdo vendimmarrje do të bazohet në respektimin e kuadrit ligjor në fuqi,duke marrë në konsideratë plotësimin e kriterëve të përcaktuara në legjislacion,përfshirë dokumentacionin e pronësisë,referuar edhe piks 1/b,të Nenit 15 "Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi" të VKM-së 408/2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit" e ndryshg 7 citohet se: <i>"1.Dokumentet që duhet të dorëzojë kërkuesi për t'u punësuar me leje ndërtimi janë:(...) b)Dokument që vërteon të drejtat pasurore te pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim,duke përfshirë edhe vërtetimet e pronësisë për zonat kadastrale të cilat nuk i janë nënshtruar regjistrimit fillestar,si dhe marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta."</i>	E plotë	Nuk ka
5	14.04.2025	Kërkesë për informacion dhe përfshirje të pronës.....	23.04.2025	Në përgjigje të shkresës Suaj,..... ju informojmë se; Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT),e cila aktualisht funksionon si Sekretariat Teknik i KKTU-së, është krijuar me VKM-në Nr.725,datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizmit dhe funksionimit të të AZHT" i ndryshuar. Në mbështetje të VKM-së sipërcituar, kjo Agjenci ka kompetencë pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit që shqyrtohet në mbledhjet e KKTU, me qëllim miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga KKTU. Referuar kërkesës tuaj,pas verifikimit të kryer,nuk rezultojnë aplikime për pajisje me leje zhviollimi/ndërtimi për pasurinë...Sa i takon informacionit të mëtejshëm lidhur me këtë projekt.....,sugjerojmë t'i drejtoheni Korporatës së Investimeve Shqiptare(AIC).	E plotë	Nuk ka

6	15.04.2025	Kërkesë	17.04.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj bëjmë me dije, si më poshtë vijon: Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT), e cila aktualisht kryen funksionet e Sekretariat Teknik të KKTU-së, në mbështetje të Vendimit Nr. 725, datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, ka kompetencë <i>pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionin që shqyrtohet dhe miratohet në mbledhjet e KKTU-së.</i> Pranë AZHT është depozituar nëpërmjet sistemit "e-leje", aplikimi Referuar Ligjit Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit". në Nenin nr.7, "Përgjegjësitë e KKTU", gërma ç), përcaktohet se: "<i>KKTU-ja vendos miratimin e rregulloreve të veçanta për kushtet e zhvillimit për rastet kompetencë e saj</i>". Në vijim sqarojmë se, në Nenin 17 "Kufizime", pika 1, shkronja "c", të Ligjit Nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", citohet se: 1. E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse <i>dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm:</i> ... c) të drejtën e autorit; <i>Kufizimi i së drejtës së informimit, për shkak të interesave të parashikuara në shkronjat "a", "b", "c" dhe</i> <i>"ç", të kësaj pike, nuk zbatohet kur titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit</i> <i>përkatës ose kur në momentin e dhënies së informacionit ai është konsideruar autoritet publik në bazë të</i> <i>parashikimeve të këtij ligji. Pavarësisht nga sa parashikohet në këtë pikë, informacioni i kërkuar nuk refuzohet në</i> <i>rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij.</i> Bashkëlidhur gjeni....	E plotë	Nuk ka
---	------------	---------	------------	--	---------	--------

7	18.04.2025	Kërkesë	28.04.2025	Në përgjigje të shkresës suaj...Ju informojmë se: AZHT, e cila aktualisht funksionon e Sekretariat Teknik të KKTU-së,është krijuar me Vendimin Nr. 725, datë 02.09.2015 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar.Në mbështetje të VKM-së sipërcituar, kjo Agjenci ka kompetencë pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionin që shqyrtohet në mbledhjet e KKTU, me qëllim miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga KKTU. Referuar Ligjit Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",sa i takon përgjegjësi të KKTU-së,në pikën 3 të Nenit 28 të tij përcaktohet se:"<i>KKTU-ja vendos miratimin e rregulloreve të veçanta për kushtet e zhvillimit për rastet kompetencë e saj. Format i TIP i kësaj rregulloreje detajohet në rregulloren e zhvillimit të territorit</i>". Pranë AZHT është depozituar nëpërmjet sistemit "e-leje",aplikimiTheksojmë se ky vendim është ende në proces zbardhjeje,proces i cili do të përfundohet vetëm pas plotësimit të kushteve sa i takon dokumentacionit tekniko-ligjor në lidhje me projektin e sipërcituar. Për sa më sipër,theksojmë se çdo vendimmarrje do të bazohet në respektimin e kuadrit ligjor në fuqi,duke marrë në konsideratë plotësimin e kriterëve të përcaktuara në ligjin nr.107/2014,datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".i ndryshuar,VKM-së 408,datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimi të territorit",i ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore në fuqi,në fushën e zhvillimit të territorit.	E plotë	Nuk ka
8	23.04.2025	Kërkesë për informacion			Në proces	Nuk ka